



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e80-të, të mbajtur më 18.01.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-4869/1 datë 11.05.2022, NDËRPRITET
KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Lënda me numër 12-4869 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-4869/1 të datës 20.07.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtruesi panjohur. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve **për pagesë të dyfishtë të shtesave për punë të personit zyrtar ///, këshilltar /// në ///. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.**

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së denoncimit, KSHPK-ja konstatoi se tashmë ka vepruar dhe ka marrë një vendim të paraqitur nën nr. 12-559/3 datë 15.06.2021. Pas rishikimit të arkivës së KSHPK-së, u konstatua se sipas pretendimeve nga denoncimi, KSHPK-ja tashmë ka vepruar, për çka vendimi i lartpërmendur është marrë në seancën e 49-të të mbajtur më 07.06.2021, e cila është shpallur publikisht në faqen e saj të internetit në formë të depersonalizuar. KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Bazuar në të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
Arkivi i KSHPK -së

Përgaditi: Mr D. D.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar
Mr. Vlladimir Georgiev

